

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“La Dolce Vita 2020 ” shpk

Ne Durres, sot me date 03/08/2020, ortakut themelues i shoqerise

“La Dolce Vita 2020 ” shpk

Znj.Franciska Szabo, e bija e Peter, i datelindjes 08.03.1996 , lindur ne Budapest Hungari e banues ne Hungari, shtetas Hungareze, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer 551334DE.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **“La Dolce Vita 2020 ” shpk**

KREU I

Neni 1

Krijimi

“La Dolce Vita 2020 ” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“La Dolce Vita 2020 ” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetas te huaj:

Znj.Franciska Szabo, i cili pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakëve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne: Lagjja 13, Rruga "Plazh", Objekt me nr pasurie 4/24+2-10, zona kadastrale 8518, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve themelues.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Agjensi Imobliliare dhe turistike

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II
Kapitali
Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (nje mijë lekë), i cili ndahet ne 1 kuota, ne raport me kontributin e dhene nga ortaket ne shoqeri ku ortaket zoterojne kuota te ndare si me poshte :

Ortaku, Znj.Franciska Szabo zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 1,000 leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit



e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise. Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket vendosin per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :



- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise “**La Dolce Vita 2020** ” shpk, caktohet brenda ortakerise.

Ortaku Znj.Franciska Szabo emerohet Administrator i shoqerise per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertesitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblee e ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per



- shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
 - f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
 - g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kan te drejt te kryen te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne shqiperin perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqeris, net e gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqeris.

Administratoret angazhon shoqerin ne mardheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merR persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e shoqeris ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prov e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti i par Financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerisë ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.



Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimi e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 “Per Qendren Kombtare te Biznesit”
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ shoqeri ne likuidim e siper”

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”, Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “**La Dolce Vita 2020**” shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Franciska Szabo

Franciska Szabo

